

NOTË INFORMUESE

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “Shkarkim nga detyra” për magjistratin E.M.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nisur hetimin disiplinor me nismë të ankuesit, Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ndaj magjistratit E.M., prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronjat “ç”, “d”, “ë”, “g” të ligjit me nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, që përcaktojnë si shkelje: *“mospërmbushja e pajustificuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit”*; *“vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale”*; *“vonesa e përsëritur dhe e pajustificuar për fillimin e seancës gjyqësore ose zvarritje e hetimeve”*; *“shkelja e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave ose prokurorisë”*; për periudhën e ushtrimit të detyrës si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë konstaton në raportin e hetimit ndaj magjistratit E.M.:

- Kryerjen e shkeljeve disiplinore nga ana e magjistratit me pakujdesi në formë neglizhence; Ekzistencën e rrethanës rënduese, pasi shkeljet janë kryer më shumë se një herë dhe i përkasin një numër të konsiderueshëm çështjesh;
- Përvojën prej 23 vjetësh si prokuror, tregues ky i njohjes shumë të mirë të tij mbi rolin e ushtrimit të detyrës me disiplinë;
- Cenimin e imazhit të sistemit gjyqësor dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë;
- Ekzistencën e rrezikut që sjellja e papërshtatshme e magjistratit subjekt hetimi disiplinor nrrezikon të ndiqet si shembull nga magjistratë të tjerë jo vetëm tek e njëjta zyrë prokurorie, krijon terren për sjellje të papërshtatshme dhe në raste të tjera të ngjashme, me rrezik serioz në besimin e publikut në administrimin e drejtësisë.

Duke konsideruar mungesën e ndonjë arsye specifike që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit të prokurorisë dhe gjyqësor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë arrin në konkluzionin se veprimet/mosveprimet e magjistratit E.M. në tërësinë e tyre përbëjnë “Shkelje shumë të rëndë disiplinore” dhe i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” për prokurorin E.M.